



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO  
**GJYKATA SUPREME E KOSOVËS**  
VRHOVNI SUD KOSOVA – SUPREME COURT OF KOSOVO

---

Numri i lëndës: 2023:079050  
Datë: 15.08.2023  
Numri i dokumentit: 04585929

**C-I-13-0026**

*Paditësi*

**B G, Pejë.**  
*Përfaqësuar nga A I, avokat.*

*Kundër*

*E paditura*

**Agjencia Kosovare e Privatizimit, rr. “Dritan Hoxha” nr. 55, Lakrishtë, Prishtinë.**

Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet në lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (Dhoma e Posaçme), Kolegji i përbërë nga Sylejman Shumolli gjyqtar kryesues, Shkelzen Sylaj dhe Diellza Hoxha gjyqtarë, pas seancës dëgjimore dhe seancës vendimmarrëse të mbajtur me 15 gusht 2023, lëshon këtë:

**A K T G J Y K I M**

- 1. Refuzohet padia e paditësit si e pa bazuar.**
- 2. Secila palë i bart shpenzimet e veta procedurale.**

**Rrethanat faktike dhe procedurale**

Me 09 tetor 2013, paditësi dorëzoi në Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme (tutje Dhoma e Posaçme), padi kundër të paditurës me bazë juridike pagimi i shumës së garancionit në vlerë prej 20,000.00 €. Paditësi pohoi se me 19 shtator 2012 është shpallur fitues sipas Valës 56 për N e R R, L në Pejë për çmimin prej 201,000.00 €, dhe pas 7 muajsh AKP-ja e ka ftuar që të bëj pagesën e 25% të çmimit të vlerës dhe ka kërkuar nga paditësi që të siguroj certifikatën mbi të kaluarën kriminale. Paditësi më tej pohon se ka bërë pagesën në shumë prej 30,250.00 €, me depozitë të pjesëmarrjes në shitje e cila e kap shumën prej 50,250.00 €, mirëpo certifikatën e të kaluarës kriminale nuk ka mundur ta siguroj dhe ka kërkuar disa herë afat shtesë dhe krejt në fund ka kërkuar të bëjë pagesën me 75% të pjesës së mbetur e pastaj të siguroj certifikatën e të kaluarës kriminale dhe ta dorëzoj në AKP. Paditësi pohoi se me përgjigjen e AKP-së të datës 10 korrik 2013, është informuar përmes shkresës zyrtare se më nuk është fitues i përkohshëm për “N R R” – L në Pejë, pasi e paditura pretendon se paditësi me 25 maj 2013 e ka marrë certifikatën mbi të kaluarën kriminale në Stacionin Policor në Pejë por nuk e ka dorëzuar tek e paditura, e ky pretendim, sipas paditësit nuk është i vërtetë. Paditësi i propozoi gjykatës që të obligohet e

paditura që ti ja kthej depozitën në shumë prej 20,000.00 €, dhe kamatën bankare në shumë prej 20,000.00 €. Nuk ka dorëzuar asnjë provë në mbështetje të padisë së tij.

Me 02 dhjetor 2015, e paditura dorëzoi mbrojtjen e saj në padi në të cilën pohoi se e kundërshton në tërësi padinë dhe pretendimet paditore të paditësit si të pabazuara. E paditura pohoi se paditësi e ka parashtruar padinë në kundërshtim me nenin 6.1 të Ligjit nr. 04/L-033, në të cilën parashihet së çdo kërkesë apo ankesë duhet të përcillet me prova se është njoftuar Kryetari i Bordit për dorëzimin e një padie të tillë së paku 60 ditë, para dorëzimit të saj. E paditura po ashtu pohoi se paditësi në padi nuk e ka theksuar bazën juridike në të cilën e mbështet kërkesëpadinë, nga kjo rrjedhë se padia është parashtruar në kundërshtim me nenin 27.2.4 të Shtojcës së Ligjit nr. 04/L-033 për DHPGJS për çështjet në lidhje me AKP-në, si dhe nenit 253 të LPK, ligji nr. 03/L006, pasi që padia nuk përmban argumentet ligjore në të cilat mbështetet kërkesëpadia. E paditura nuk e konteston faktin se paditësi ka marr pjesë në ofertat e shitjes dhe është radhitur si ofertues i parë i lartë sipas rregullave të përgjithshme të tenderit, mirëpo nuk ka përmbush kushtet e përcaktuar sipas rregullave të përgjithshme të tenderit, pra paditësi ka dështuar të kryen verifikimin e historikut ashtu siç është përcaktuar me nenin 11.1 të Rregullave të Tenderit. Në Rregullat e Tenderit në pikat 12.3, është baza ligjore me të cilin i lejohet AKP-së, që në rastet kur ofertuesi fitues për çfarëdo arsye dështon të siguron verifikimin e historikut brenda afatit, ti konfiskohet depozita e ofertës. Në mbështetje të mbrojtjes së saj e paditura dorëzoi Njoftimin nr. 603 të datës 10 korrik 2013 për konfiskimin e depozitës dhe vazhdimin e shitjes me ofertuesin e radhës.

Me 04 prill 2023, gjykata lëshoi urdhër për paditësin duke kërkuar nga i njëjti që ta precizoj padinë dhe të dorëzoj prova relevante në mbështetje të padisë së tij, e veçanërisht në lidhje me certifikatën e të kaluarës kriminale si dhe të bëj pagesën e taksës gjyqësore. Me 20 prill 2023, paditësi pagoi taksën gjyqësore.

Me 26 prill 2023, paditësi përmes të autorizuarit të tij dorëzoi parashtresë në të cilën pohoi se pretendimet e të paditurës se kinse paditësi nuk e ka theksuar bazën juridike të kërkesëpadisë nuk qëndron, ngase baza juridike e kërkesëpadisë është përcaktuar në mënyrë të qartë në padi. Paditësi pohoi se pa fajin e tij është duke pësuar dëm të konsiderueshëm material nga fakti se e paditura nuk ia ka kthyer garancionin për pjesëmarrje në tender në lartësi prej 20,000.00 € dhe se konfiskimi i shumave monetare (garancionit) apo eventualisht ndonjë “mjete”, “paluajtshmërie” etj, mund të bëhet vetëm me aktgjykim penal të formës së prerë të gjykatës kompetente, e i cili aktgjykim penal i formës së prerë në rastin konkret mungon. Paditësi pohoi se në këtë çështje juridike duhet aplikuar institucioni i pasurimit të pa bazë, në kuptim të nenit 194 par. 1 të LMD-së (Ligji nr. 04/L-077, i publikuar në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës nr. 16 dt. 19 qershor 2012, i cili është në implementim nga dt. 20 dhjetor 2012 e tutje), i cili parasheh “ *Secili person që pasurohet pa bazë ligjore në dëm të një tjetrit, është i detyruar të kthejë atë që ka marrë nga tjetri ose ndryshe të kompensoj vlerën e fitimit të arritur*”. Po ashtu edhe neni 194 par. 3 i LMD-së parasheh së “ *Detyrimi për kthim ose kompensim po ashtu lind edhe nëse një person pranon diçka në lidhje me një bazë që nuk është realizuar ose më pas zhduket*”. Paditësi i propozon gjykatës që të aprovohet kërkesëpadia e paditësit ashtu që të detyrohet AKP-ja që në emër të begatimit të pa bazë të ia paguaj paditësit shumën prej 20,000.00

€, si dhe t'ia kompensoj të gjitha shpenzimet e shkaktuara procedurale, e të gjitha këto në afat prej 15 ditësh, nga dita e marrjes së aktgjykimit nën kërcënim të përmbarrimit. Në mbështetje të parashtrësës i autorizuari i paditësit dorëzoi Autorizimin për përfaqësim të paditësit, si dhe dëshmitë si: Njoftimin për moskthimin e shumës së depozituar nr. 603, datë 24 shtator 2012, Njoftimin e për shpalljen fitues i përkohshëm dhe kërkesën për sigurimin e certifikatës për të kaluarën kriminale, datë 28 mars 2013, Kërkesën për mundësimin e pagesës së mbetur prej 75% për blerjen e lokalit datë 22 qershor 2013 dhe Kërkesën - Njoftimin drejtuar AKP-së nr. 2204/2016 datë 10 mars 2016 për certifikatën mbi të kaluarën kriminale dhe pagesën e depozitës.

Me 05 qershor 2023, u mbajt seancë dëgjimore në të cilën prezantuan paditësi dhe përfaqësuesi i tij z. A I, avokat nga Gjakova dhe përfaqësuesja e AKP-së Znj. V H.

Në këtë seancë përfaqësuesi i paditësit në fjalën e tij deklaroi se mbetet në tërësi pranë parashtrimeve nga padia, pretendimeve nga parashtrësja e dërguar rekomande ne këtë gjykatë me dt.24.04.2023 duke theksuar se në rastin konkret duhet të aplikohet instituti i begatimit të pa bazë dhe se për tu aplikuar ky institut duhet të ekzistoj pasurimi i pa bazë "*conditio sine causa*" me ç'rast duhet të plotësohen këto kushte: Të shkaktohet pasurimi i personit tjetër, pasurimi të jetë i pa bazë, pasurimi të jetë në llogari të tjetrit dhe me këtë të shkaktohet varfërimi i personit tjetër siç ka ndodhur me rastin konkret tek pala paditëse. Përfaqësuesi i paditësit më tej deklaroi se tek rasti i paditësit janë plotësuar të gjitha këto kushte. Është rrethanë jo kontestuese fakti se paditësi ka deponuar në emër të garancionit për blerjen e lokalit të shpallur sipas valës 56, shumën prej 20,000.00 euro e cila shumë deri më tani nuk i është kthyer palës paditëse. Pala e paditur këtë shumë e mban pa bazë juridike dhe pa fajin e paditësit ngase e njëjta dmtsh e paditura e ka realizuar qëllimin e saj duke i dhënë lokalin në fjalë një personit tjetër. Për më tepër pala paditëse ka paguar shumën prej 30,250.00 euro e cila shumë i është kthyer paditësit, por i njëjti në at kohë ka qenë i gatshëm që të paguaj në tërësi çmimin e caktuar me rastin e tenderimit. Nuk qëndron fakti i palës së paditur se kinse paditësi e ka marr certifikatën mbi të kaluarën e tij eventuale kriminale me dt.25.05.2013. barra provës për këtë ne kuptim të nenit 322 të LPK-së i takon palës së paditur. Paditësi ka siguruar provë se nuk ka marrë as një vërtetim me dt. 25.05.2013, nga Policia e Kosovës, Stacioni Policor në Pejë sepse në të kundërtën nuk ka pas arsye që të ja prezantoj gjykatës. Çështja e rregullores së apostrofuuar nga pala e paditur është jo relevante në rastin konkret. Këtë nga fakti se rregullorja nuk e ka fuqinë e ligjit në këtë rast të LMD-së. As një paluajtshmëri apo shumë monetare nuk mund të konfiskohet pa bazë ligjore, e baza ligjore në rastin konkret duhet të jetë aktgjykimi penal i formës së prerë i gjykatës kompetente i cili aktgjykim në rastin konkret mungon.

Përfaqësuesja e AKP-së në fjalën e saj deklaroi se mbetet në tërësi pranë përgjigjes në padi dhe gjithashtu kundërshton të gjitha deklaratimet e thëna në këtë seancë nga përfaqësuesi i paditësit kjo me arsyetimin se paditësi para se të ofertoj në procedurat e privatizimit në AKP paraprakisht është njoftuar me të gjitha rregullat e procedurës së blerjes të asetit të tenderuar. Në rastin konkret paditësi ka qenë i njoftuar se duhet të dorëzoi verifikimin e historikut e cila është e përcaktuar me dispozitat ligjore të rregullave të përgjithshme të tenderit. Në rastin konkret paditësi pasi që është njoftuar se është shpallur ofertues fitues dhe gjithashtu është njoftuar se duhet që deri me 26 prill 2013 krahas kështit të parë të pagesës ta dorëzoi edhe verifikimin e historikut, me kërkesën

e paditësit afati për dorëzimin e verifikim të historikut është shtyrë, përkundër faktit AKP edhe pse vazhdimisht përmes dy muaj të tërë ka kërkuar nga ofertuesi (paditësi) që të dorëzoj verifikimin e historikut arsyetimi ka qenë se akoma nuk e ka siguruar nga organet policore. Por AKP ka kontaktuar edhe me organet e policisë sepse edhe ja lejojnë rregullat e tenderit me 26 qershor 2013 dhe nga Policia e Kosovës ka marrë këtë konfirmim ku thuhet se B G është pajisur me vërtetimin e të kaluarës kriminale me datë 22 maj 2013 por pavarësisht këtij fakti AKP përkatësisht bordi i drejtorëve të AKP-së për hir të korrektësisë ka pritur edhe një muaj dhe me 10 korrik 2013 paditësi është njoftuar se anulohet shitja dhe kësti i parë i pagesës në shumë prej 25% i kthehet kurse depozita i ndalet si pasojë e mos përmbushjes së detyrimeve të përcaktuara me rregullat e përgjithshme të tenderit, andaj si rrjedhojë AKP nuk mbahet përgjegjëse për çfarëdo vonese në përfundimin e shitjes së subjektit të ri ose çfarë do humbje pasuese që i shkaktohet ofertuesit fitues të përkohshëm e që ndërlidhet me kohëzgjatjen e përfundimit të historikut, prandaj mbi këtë bazë AKP gjykatës i propozon që kërkesëpadinë e paditësit ta refuzon si të pabazuar, gjithashtu gjykatës i dorëzoi edhe rregullat e përgjithshme të tenderit.

Pas shqyrtimeve kolegji vendosi që t'i jepet afat 15 ditor përfaqësuesit të paditësit për dorëzimin e dëshmimeve përkatëse dhe vërtetimin për të kaluarën e tij kriminale për periudhën objekt kontesti. Gjithashtu brenda këtij afati palët do të dorëzojnë fjalët e tyre përfundimtare me shkrim.

Me 08 qershor 2023, përfaqësuesi i paditësit dorëzoi një parashtrësë dhe fjalën përfundimtare. Përfaqësuesi i paditësit thekson se paditësi me 30 prill 2013 e ka njoftuar AKP-në, se ka kërkuar nga organet kompetente për të “kaluarën eventuale kriminale” dhe se të njëjtit i kanë treguar se në vitin 2002 e ka pasur një vepër penale të falsifikimit të dokumentit zyrtar nga neni 203 al. 3 të LPK dhe se procedurat në gjykatë dhe polici zgjasin të paktën 45 ditë. Në fjalën e tij përfundimtare përfaqësuesi i paditësit propozon që të aprovohet kërkesëpadia e precizuar e paditësit në parashtrësën e datës 20 prill 2023, të aprovohet në tërësi si e themeltë dhe të detyrohet e paditura që palës aktive në procedurë të ia kompensoj edhe shpenzimet e shkaktuara procedurale, të gjitha këto në afatin partitiv prej 15 ditëve, nga dita e marrjes së aktgjykimit. Si përfundim përfaqësuesi i paditësit thekson se në rastin konkret në mënyrë absolute gjen zbatim dispozita 194.1 e LMD (Ligji nr. 04/L-077), e cila dispozitë ligjore ka paraparë se “*Secili person që pasurohet pa bazë ligjore në dëm të një tjetrit, është i detyruar të kthej atë që ka marr nga tjetri, ose ndryshe të kompensoj vlerën e fitimit të arritur.*” Ndërsa në asnjë mënyrë në procedurën gjyqësore të kësaj çështje juridike nuk mund të zbatohen dhe të gjejnë aplikim rregullat e përgjithshme të tenderit të cilat nuk e kanë fuqinë ligjore të LMD (por janë rregulla të punës, në kuadër të AKP-së) dhe në kundërshtim të plotë me dispozitat ligjore të LMD-së, të cilat janë të destinuara për begatim pa bazë, siç është kontesti lëndor në rastin konkret. Përfaqësuesi i paditësit konsideron se kërkesëpadia e precizuar e paditësit është në tërësi e themeltë dhe si të këtyllë i propozon gjykatës që ta aprovoj dhe të detyroj të paditurën që të ia kompensoj edhe shpenzimet (e precizuara) procedurale. Në mbështetje të saj dorëzoi dëshmitë në kopje si: Kërkesën e datës 30 prill 2013, drejtuar AKP-së, Aktgjykimin P.nr. 42/2002 të datës 29 prill 2002 dhe Kërkesën për shlyerjen e dënimit datë 25 prill 2013, drejtuar Gjykatës Themelore në Pejë.

Me 13 qershor 2023, përfaqësuesi i paditësit dorëzoi një parashtrësë me dëshmitë mbështetëse si: Kërkesën drejtuar Gjykatës Themelore në Pejë, datë 09 qershor 2023 për dorëzimin e një ekzemplari të aktgjykimit P.nr. 42/2002, datë 29 prill 2002 dhe kopjen e vërtetuar të këtij aktgjykimi.

Me 11 gusht 2023, e paditura dorëzoi fjalën e saj përfundimtare, ku ndër të tjera theksoi se paditësi ishte i njoftuar me procedurat dhe rregullat e tenderit dhe meqë i njëjti kishte dështuar në përmbushjen e obligimeve ligjore, e paditura e ka njoftuar të njëjtin se shitja është anuluar dhe kësti i parë i pagesës në shumën prej 25 % i është kthyer, kurse depozita është ndalur si pasojë e mos përmbushjes së detyrimeve të përcaktuara me rregullat e përgjithshme të tenderit konform dispozitës së nenit 12.3 të Rregullave të Tenderit, depozita në shumë prej 20,000.00 € është konfiskuar. E paditura i propozoi gjykatës që të refuzoj si të pabazuar kërkesëpadinë e paditësit.

### **Arsyetimi ligjor:**

Padia e paditësit është e pa bazuar.

Në bazë të nenit 2.4 dhe nenit 77.1.1.1 të Ligjit Nr.06-L-086 të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (në tekstin e mëtejme Ligji për Dhomën e Posaçme), gjykata zbaton dispozitat procedurale të këtij ligji.

Neni 42 pika 2 e Ligjit për Dhomën e Posaçme, parasheh se *pala që pretendon një fakt apo ngjarje ka barrën e dëshmisë për të dëshmuar vërtetësinë e pretendimit të tillë, duke paraqitur parashtrësas apo duke paraqitur provat materiale (të dokumentuara, fizike dhe/ose dëshmuese)*, ndërsa pika 3 parasheh se, *pala që pretendon një fakt apo ngjarje ka mundësinë e arsyeshme për të paraqitur apo dorëzuar provat materiale për të mbështetur një pretendim të tillë, nëse pala e tillë dështon që të paraqesë apo dorëzojë provat e tilla, atëherë vlerësohet se pala nuk ka ofruar barrën e dëshmisë lidhur me pretendimin e tillë.*

Sipas nenit 7 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, palët kanë për detyrë ti paraqesin të gjitha faktet mbi të cilat i mbështesin kërkesat e veta dhe të propozojnë prova me të cilat konstatohen faktet e tilla. Me fjalë të tjera, kushdo që thotë diçka duhet ta dëshmojë atë (*ei incumbit probatio qui dicit*).

Gjykata ka shqyrtuar me kujdes të gjithë dokumentacionin e dorëzuar në gjykatë në lidhje me këtë çështje juridike kontestuese dhe gjen se padia e paditësit për kthimin e depozitës objekt kontesti nuk mbështetet në prova, andaj si e tillë edhe refuzohet. Nga shkresat e lëndës sipas padisë së dorëzuar dhe precizimeve të saj si dhe deklarimeve në seancën dëgjimore të datës 05 qershor 2023, del se paditësi e mbështet padinë e tij kryesisht në pretendimin se i njëjti nuk ka marr kurrfarë vërtetimi për të kaluarën e tij kriminale nga organet kompetente përkatësisht Policia e Kosovës, dokument ky i kërkuar nga e paditura për të përmbushur një nga kriteret ligjore të parapara me Rregullat e Përgjithshme të Tenderit për pjesëmarrje në procesin e

privatizimit të njësisë N e R R L në Pejë, Vala 56 e Privatizimit datë 19 shtator 2012. Gjykata konsideron se paditësi ka dështuar që ta bëjë të besueshme për gjykatën këtë fakt kjo pasi i njëjti dorëzoi vetëm një provë (Aktgjykimin P.nr. 42/2002 të datës 29 prill 2002) e cila nuk është relevante, pasi i referohet një periudhë kohore tjetër përkatësisht vitit 2002. Për më tepër, e paditura gjatë seancës dëgjimore dorëzoi dëshmi të mjaftueshme të cilat e konfirmojnë të kundërtën e asaj që pretendon paditësi, përkatësisht dëshmi se i njëjti kishte marrë certifikatën për të kaluarën e tij kriminale por (siç duket duke ditur pasojat) të njëjtën nuk e kishte dorëzuar tek e paditura në procesin e privatizimit të N R R L në Pejë, Vala 56 e Privatizimit, datë 19 shtator 2012. Kjo vërtetohet nga përgjigja e Sektorit për Mbështetje të Inteligjencës –Drejtoria e Inteligjencës dhe Analizës e Policisë së Kosovës, e datës 26 qershor 2013 drejtuar AKP-së, ku në pikën 4, ceket se paditësi është pajisur me vërtetim mbi të kaluarën kriminale me 22 maj 2013. Prandaj, pretendimi i tillë refuzohet.

Pretendimin tjetër të paditësit se e paditura nuk mund të zbatohet Rregullat e Përgjithshme të Tenderit në rastin objekt kontesti pasi të njëjtat janë në kundërshtim me dispozitat e LMD-së dhe se kërkesëpadia e paditësit përbën rast të pasurimit të pabazë për të paditurën, gjykata e konsideron si të pabazuar në ligj. Rregullat e Përgjithshme të Tenderit janë dispozita me karakter detyrues për palët pasi të njëjtat janë nxjerr nga e paditura në pajtim me ligjin për Agjencinë Kosovare të Privatizimit dhe si të tilla janë rregulla speciale të cilat janë të zbatueshme para së gjithash në procedurat e privatizimit, prandaj në rastin konkret nuk gjejnë zbatim dispozitat përkatëse të pasurimit të pabazë të LMD. Për më tepër, paditësi ishte në dijeni paraprakisht me të gjitha kriteret ligjore dhe procedurat për pjesëmarrje në procesin e privatizimit, andaj referenca në dispozitat ligjore të Ligjit për Marrëdhëniet e Detyrimeve, nuk mund të aplikohet në rastet e tilla.

Nisur nga kjo gjendje gjykata vjen në përfundim se padia e paditësit për kthimin e depozitës në shumë prej 20,000.00 €, për pjesëmarrje në procesin e privatizimit të njësisë N R R L në Pejë, Vala 56 e Privatizimit datë 19 shtator 2012, nuk gjen mbështetje në asnjë dispozitë ligjore andaj si e tillë edhe refuzohet.

Gjykata konsideron se ka vlerësuar të gjitha pretendimet relevante të palëve në lidhje me objektin e kontestit. Nuk ka pretendime të tjera të cilat mund të ndikojnë për të vendosur ndryshe në këtë çështje.

Andaj në bazë të të lartcekurave dhe në pajtim me nenin 54.1 të Ligjit për Dhomën e Posaçme, u vendos si në dispozitiv të aktgjykimit.

### **Taksat gjyqësore**

Në bazë të nenit 62.5 të Ligjit për Dhomën e Posaçme, secila palë do të mbulojë shpenzimet e veta. Paditësi ka paguar taksën gjyqësore në shumë prej 100.00 € dhe nuk ngarkohet me taksë shtesë.

## **Këshilla juridike**

Kundër këtij aktgjykimi mund të parashtrohet ankesë me shkrim në Kolegjin e Apelit të Dhomës së Posaçme brenda 15 ditëve nga pranimi i këtij aktgjykimi. Ankesa duhet të dorëzohet në bazë të nenit 9.6 të Ligjit për Dhomën e Posaçme.

Sylejman Shumolli, Gjyqtar kryesues

Shkelzen Sylaj, Gjyqtar

Diellza Hoxha, Gjyqtare